



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.68/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi, dhe Hidajete Gashi Alaj-anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, parashtuar kundër subjektit politik “Kosova Demokratik Turk Partisi”, kandidati (Sefçet Damka) me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.68/2025 datë 26.09.2025.

II. Subjektit politik “Kosova Demokratik Turk Partisi” me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 500,00 Euro (pesëqind Euro).

IV. Detyrohet Subjekti politik “Kosova Demokratik Turk Partisi” (KDTP), me seli në Prizren, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën theksohet se më datë 25.09.2025 kandidati i KDTP-së Sefçet Damka, ka vendosur material reklamues zgjedhor në murin e parkut “Ata Turku” në Kurillë, Komuna e Prizrenit. Ky park përbën pronë publike dhe vendosja e materialeve zgjedhore në prona publike është e ndaluar me Ligjin për Zgjedhjet dhe aktet nënligjore të KQZ-së.

Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore. Konform Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve, postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda dhe jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, ose rrugët publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të ndryshme, që janë pronë ose menaxhohen nga autoritetet qendrore brenda ose në hapësira private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesëve.

Në këtë rast, në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë parasysh shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e kandidatit të KDTP-së, PZAP-it i kërkojnë që të nxjerrë vendim me të cilin e aprovon këtë ankesë.

Në përgjigje në ankesë “Kosova Demokratik Turk Partisi” (KDTP), thekson se: objekt i ankesës ka ndodhur me 25 shtator 2025, sipas informacionit që kishte arritur në selinë e partisë, është kontaktuar menjëherë kandidati dhe i është kërkuar që materialet e fushatës, të vendosura në hapësirën publike, të hiqeshin menjëherë. Kandidati z. Sefçet Damka, pas urdhërit të Partisë, të njëjtën ditë me dt. 25.09.2025, i kishte hequr materialet përkatëse dhe ishte siguruar që shkelja mos të vazhdonte.

Më tej në përgjigje shtohet se sipas dëshmisë verbale të kandidatit dhe hetimin e brendshëm partiak ai deklaroi se nuk kishte dijeni (ose nuk e kishte kuptuar plotësisht) që vendi ku u vendos materiali ishte hapësirë publike, pasi Partia e informoi, ai veproi menjëherë për të korrigjuar mangësitë dhe shprehu keqardhje e pendim për veprimin e tij.

Megjithatë, menjëherë pas pranimit të kësaj ankese, kandidati i tyre ka ndërmarrë veprim të menjëhershëm dhe ka larguar posterin e tij nga vendi i kontestuar, duke demonstruar vullnetin e plotë për respektimin e rregullave zgjedhore dhe për mbajtjen e një gare të drejtë dhe të barabartë.

Si prove në përgjigje ka bashkangjitur foton e heqjes së posterit i cili ishte vendosur në murin e parkut “Ata Turku” në Kurillë, Prizren.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se kandidati i subjektit politik “Kosova Demokratik Turk Partisi” (KDTP), Sefçet Damka ka vendosur poster zgjedhor në murin e parkut “Ata Turku” në Kurillë, Prizren.

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur Rregullën Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që është shfrytëzuar hapësira publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 nën paragrafi 2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se 1.2.” *vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e*

emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati Sefçet Damka nga radhët e subjektit politik “Kosova Demokratik Turk Partisi” (KDTP), ka shfrytëzuar hapësirën publike murin e parkut “Ata Turku” në Kurillë gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të zhvillimit të fushatës zgjedhore dhe përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimi i kandidatit të subjektit politik KDTP në Prizren, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës Zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti Politik “Kosova Demokratik Turk Partisi” (KDTP), ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik KDTP, si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se është larguar posteri nga vendi i kontestuar, që tregon se është bërë përpjekje serioze për evitimin e shkeljes së bërë, si dhe praktikën e PZAP-it, për rastet të ngjashme, të vendosura në PZAP.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 36 paragrafi 1.2 neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.68/2025 më datën 29.09.2025

Kryesues i Panelit,
Kujtim Pasuli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.